



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 37/3 Prot

Tiranë, më 15.04.2021

V E N D I M

Nr.41, datë 15.04.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt parregullsi gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit, me kod # 3316, për ngritje në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, për pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Ligjore, në Drejtorinë Teknike dhe Ligjore”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të një kërkesë të paraqitur prej aplikantit, *****.

Vërej se:

Konkurenti *****, nëpërmjet një kërkesë protokolluar me nr. 930 prot., datë 21.12.2020, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të lejuara nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë realizimit të procedurës së ngritjes në detyrë, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Ligjore, në Drejtorinë Teknike dhe Ligjore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (kategoria III-a/1, me kod # 3316).

Sipas tij, Departamenti i Administrës Publike, në fazën e verifikimit paraprak, gjatë kësaj procedure, pa të drejtë i ka nxjerrë pengesa në lidhje me llogaritjen e vjetërsisë së nevojshme,

duke rrezikuar skualifikimin, ndërkohë që ka favorizuar aplikantë të cilët nuk përmbushnin kriterin e vendosur në shpallje *“të paktën 3 vite në profesion”*.

Pas marrjes së informacionit të mësipërm ka nisur verifikimi paraprak i këtij rasti nga Komisioneri, duke kërkuar sqarime dhe dokumentacionin e nevojshëm nga Departamenti i Administratës Publike, i cili u përgjigj në lidhje me pretendimet e ankuesit, nëpërmjet shkresës nr. 260/1, datë 21.01.2021, *“Kthim përgjigje suajës nr. 37 prot., datë 11.01.2021”*, nga përmbajtja e të cilit rezultoi si më poshtë:

Departamenti i Administratës Publike (DAP) në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, si dhe Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242 datë 18.03.2015, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar, ka shpallur procedurën për lëvizje paralele dhe të ngritjes në detyrë, e cila është objekt shqyrtimi.

Bazuar në pikën 13, Kreu II, të aktit nënligjor të përmendur më sipër, duke qenë se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, mbas verifikimit paraprak të kërkesave të posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurim, nuk u paraqit asnjë kandidat, njësia përgjegjëse (DAP) mbylli procedurën e lëvizjes paralele pa kandidatë fitues dhe vazhdoi me procedurën e ngritjes në detyrë.

Në vijim, njësia përgjegjëse në zbatim të nenit 22, të VKM nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, ka bërë vlerësimin paraprak të dosjeve të kandidatëve që kishin aplikuar për ngritje në detyrë, (kandidatët, të cilët kishin ngarkuar dosjen individuale, në një llogari personale, në portalin e DAP) nëse i plotësonin kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës të përcaktuara në shpalljen për publikim. Sipas vlerësimit të Komisionit të paraseleksionimit, aplikantët e kualifikuar për të vazhduar në fazën e dytë, atë të testimit me shkrim, ishin shtetaset ***** dhe ***** , kurse aplikanti ***** nuk është kualifikuar, për mosplotësim të kriterit të vjetërsisë në punë.

Me qëllim që të respektohej e drejta e ankimit dhe kandidati, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike të kishte mundësi të paraqiste ankesë me shkrim pranë njësisë përgjegjëse, bazuar në pikën 14, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, nëpërmjet e-mailit të datës 14.12.2019, ai është njoftuar konkretisht, për shkaqet e skualifikimit, si më poshtë:

- *Nuk keni ngarkuar vërtetim që keni masë disiplinore në fuqi, i cili duhet të jetë i muajit të fundit;*
- *Nuk keni ngarkuar vlerësimin e fundit të periudhës Janar – Qershor 2020, i cili duhet të jetë “mirë” apo “shumë mirë”;*
- *Nuk plotësoni kriterin e përvojës së punës, të paktën 3 vite në profesion.*

Në këto rrethana, aplikanti në fjalë, paraqiti ankesën me shkrim, së bashku me dokumentacionin e tij shtesë në DAP, në datën 17.12.2020 (*pasi ai pretendon se sistemi nuk e pranonte*).

Njësia përgjegjëse, ka rivlerësuar edhe njëherë dosjen së bashku me dokumentacionin shtesë të paraqitur prej tij, nga ku rezultoi se kishte ngarkuar formularin e fundit të vlerësimit të punës, për periudhën Janar – Qershor 2020, “*shumë mirë*” dhe njëkohësisht vërtetimin që nuk kishte masë disiplinore në fuqi, (*akti nr. 23582 datë 17.12.2020, lëshuar nga sekretari i Përgjithshëm i MFE*). Pas kësaj, rezulton se DAP, përsëri e ka skualifikuar aplikantin në fjalë, me arsyetimin e mospërbushjes së kriterit të vjetërsisë, të paktën 3 vite në profesion.

Në këto kushte, ai ka depozituar ankesën pranë Komisionerit, duke e vënë në dijeni për moszbatimin dhe moskuptimin e drejtë të ligjit dhe favorizim të aplikantëve të tjerë të cilët gjithashtu, nuk përmbushin kriterin e përvojës së punës “*të paktën 3 vite në profesion*”, duke kërkuar për këtë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar prej tyre, si dhe duke sqaruar se është skualifikuar pa të drejtë, me pretendimin se i plotëson kriteret e vendosura (*duke paraqitur pranë Komisionerit dokumentacionin e dorëzuar në DAP si dhe dokumentacionin shtesë, dorëzuar në ankesën e tij*).

Mbi bazën e këtyre pretendimeve të ngritura prej aplikantit ***** , procesi i verifikimit filloi nga Komisioneri, me shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur prej tij, për të vërtetuar vjetërsinë e kërkuar. Aplikanti, për të vërtetuar eksperiencën në punë, kishte ngarkuar në sistem librezën e punës dhe një dokument të lëshuar nga Av. ***** , i cili vërtetonte se ai ishte regjistruar si asistent avokat pranë zyrës së tij, për vitin akademik 2017-2018, gjatë kohës që ishte duke ndjekur programin e trajnimit fillestar, pranë shkollës së avokatisë, si detyrim ligjor për fitimin e titullit “*Avokat*” në RSH, kohë e cila njihet si vjetërsi në punë (*dokument i cili nuk ishte marrë në konsideratë nga DAP*).

Njëkohësisht, nga shënimet e bëra në librezën e tij të punës, ka rezultuar se deri në momentin e aplikimit, kandidati në fjalë kishte 2 vite dhe 6 muaj eksperience pune si jurist, ashtu si do ta evidentojmë në vijim:

- 19 qershor 2018 – 24 Janar 2020, Specialist Sektori Juridik, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës ;
- 24 Janar 2020 – e në vazhdim (dhjetor 2020, afati i aplikimit) Specialist në Sektorin e Ankesave, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në MFE (kalim nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele).

Duke marrë parasysh se në bazë të nenit 20, të ligjit 55/2018 “*Për profesionin e avokatit në RSH*”, periudha e stazhit njihet si vjetërsi në punë, njësia përgjegjëse bëri edhe një herë

vlerësimin e dosjes së aplikantit ***** , në përfundim të të cilës u konsiderua i plotësuar kriteri i vjetërsisë së vendosur në shpalljen për konkurrim dhe ai u njoftua se ishte i kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë, atë të testimit me shkrim, në datën 11.01.2021, në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Në datën e caktuar u krye testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë, në përfundim të të cilës, procedura e konkurrimit nuk rezultoi me fitues, për shkak se asnjë prej konkurrentëve nuk mundi të marrë pikët e nevojshme.

Me këtë përfundim të procesit të konkurrimit, mosmarrëveshja e lindur, e cila u bë shkak për fillimin e këtij hetimi administrativ, ka humbur objektin e saj, por nga mënyra si u zhvillua kjo procedurë administrative, lind i nevojshëm sqarimi i paqartësisë konceptuale që përbënte thelbin e mosmarrëveshjes: është fjala për dallimin ndërmjet konceptit “*vjetërsi në punë*” dhe konceptit “*vjetërsi në profesion*”, që u bë shkak i konfuzionit në këtë rast.

Koncepti i “*vjetërsisë në punë*”, është koncept i gjërë, me natyrë të përgjithëshme, që origjinën e ka nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore. Vjetërsia në punë përfshin të gjitha marrëdhëniet e rregullta të punës, sipas së cilës punëmarrësi plotëson kushtet e mëposhtme:

- 1) ka kryer punën e ngarkuar, ose të parashikuar në marrëveshjen e punës;
- 2) ka marrë pagën e caktuar për kryerjen e punës;
- 3) ka paguar kuotën e sigurimeve shoqërore, të caktuar në bazë të legjislacionit përkatës.

Kurse, koncepti i “*vjetërsisë në profesion*” është një koncept, me kuptim më të ngushtë, i lidhur me kohën gjatë të cilës, punëmarrësi i plotëson të tre elementët e mësipërm, por që punën duhet ta ketë kryer në një profesion të caktuar, ose në një profesion të ngjashëm, sipas përcaktimeve të bëra në diplomë apo në akte të ndryshme ligjore e nënligjore.

Nisur nga sa më sipër, nga ana e njësisë përgjegjëse, është treguar kujdes që të mbahet parasysh dallimi ndërmjet koncepteve të vjetërsisë në punë dhe asaj në profesion.

Në rastin konkret, pranimi për të marrë pjesë në konkurrim i kërkuesit ***** , është i justifikuar, pasi në përfundim të rivlerësimit të dosjes së tij, rezultoi se ai kishte vjetërsi në profesionin e juristit në masën mbi tre vjet.

Nisur nga gjithë sa u tha më sipër, konkludohet se në rastin konkret, në kuptimin e mosmarrëveshjes individuale të lindur, nuk ka vend për vazhdimin e mëtejshëm të hetimit administrativ, pasi mungon objekti i ankesës, në kushtet kur konkurrimi ka përfunduar pa fitues, për një shkak të ligjshëm dhe për këtë arsye çështja të arkivohet.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të regjistruar me nr. 930 prot., datë 21.12.2020, në lidhje me procedurën e konkurimit për ngritje në detyrë të aplikantit ***** dhe arkivimin e çështjes, pasi mungon objekti.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike dhe aplikanti *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha